

Date: 08/11 /2024

**NJOFTIMI PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË
KOMBËTARE TË MJEDISIT/AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV
KU DO TË KETË VENDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM PËR TU PAJISUR
ME LEJE MJEDISI TË INSTALIMIT TË TIPIT A OSE B / NDRYSHIME NË
FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TË TIPIT A DHE B**

Bazuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, Ligjin Nr. 60/2014, datë 19.6.2014 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar dhe VKM 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, Kreu VI “Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B”, pika 2, Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për “Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B” apo “Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B”; **APLIKIM PËR LEJE TE MJEDISIT TË TIPIT B**
2. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së; “**LUXURY MICRON**”, **NIPT: M41408510P**
3. Adresën e vendndodhjes së instalimit: **Durres Shijak Bashkia Shijak Njësia Administrative: Xhafzotaj, Fshati: Xhafzotaj, Rruga Kryesore, Pasuria Nr.308/12, ZK.3852**
4. Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim; **ID 2.5 b “Shkrirja dhe përftimi i aliazheve të metaleve joferrose (me ngjyrë) përfshirë produktet e rikuperuar (duke përfshire rafinimin dhe derdhjen në fonderi). + ID 7.9e. Përveç rasteve të përmendura në 7.9.c dhe 7.9.d, çdo proces (duke përjashtuar ri-ngjyrosjen ose ri-sprucimin plotësisht ose pjesërisht të avionëve, mjeteve të transportit hekurudhor ose rrugor) për aplikime mbi nënshtresat ose që bën tharjen, ose kujdeset pas këtyre aplikimeve, stampon me bojë ose ngjyros ose aplikon çdo material tjetër veshës si një veprimtari prodhimi ose gjatë veprimtarisë së prodhimit**
5. Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
6. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar, kur kërkohet procedura e VNM-së në CD;
7. Konsultimet ndërkuftare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi; **NUK KA**
8. Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen; **AGJENSIA KOMBËTARE E MJEDISIT.**
9. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit; **info@akm.gov.al**

Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 CD/DVD

Kërkuesi/Përfaqësuesi i shoqërisë
(Dritan Arapi)



Adresa emailit dhe nr kontakti
sek.lejemjedisore@yahoo.com

0698591968